



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen gjyqësore kundër Sabit Januzit dhe Ismet Bahtijarit, lëshoi të premtën, më 27 tetor, urdhrin për mbajtjen e një konference mbi ecurinë e çështjes me palët më 3 nëntor, në orën 9:30 paradite.

Gjykatësi i Procedurës Paraprake do t'u kërkojë palëve përditësime lidhur me aspekte ende të patrajtuara të përcaktuara në rendin e ditës, si vështirësitë lidhur me nxjerrjen ose përkthimin e materialit provues, ecurinë e hetimeve të ZPS-së dhe kur do të jetë në gjendje ZPS-ja të dorëzojë dosjen paraprake.

Në çështjen gjyqësore *Thaçi dhe të tjerët*, dëshmitari i 31-të i thirrur nga Prokuroria dha dëshmi të hënën, 30 tetor. Dëshmitari dha dëshmi me masa mbrojtëse dhe kryesisht në seancë të mbyllur. Dëshmitari i 32-të ka filluar dhënien e dëshmisë sot paradite, nëpërmjet videokonferencës dhe kryesisht në seancë publike.

Më 31 tetor, u vu në dispozicion versioni i redaktuar publik i vendimit të Trupit Gjykues mbi një kërkesë të Mbrojtjes së Thaçit. Mbrojtja e Thaçit kishte kërkuar leje për të intervistuar një dëshmitar të Prokurorisë përpara se dëshmitari të jepte dëshmi dhe pa praninë e Prokurorisë.

Trupi Gjykues hodhi poshtë kërkesën e Mbrojtjes dhe e udhëzoi atë që t'i përmbahet procedurës së përcaktuar në vendimin përkatës për kontaktet.

Më 24 qershor 2022, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin që përcakton kornizën për trajtimin e informacionit konfidencial gjatë hetimeve dhe kontaktet midis një pale dhe dëshmitarëve të palës tjetër. Sipas atij vendimi, përpara dhënies së dëshmisë, palët nuk e kontaktojnë dhe as nuk e intervistojnë një dëshmitar të palës tjetër, nëse pala kundërshtarë është njoftuar për synimin për të thirrur dëshmitarin. Megjithatë, kur një palë gjykon se kanë ndryshuar rrethanat, ato mund të kërkojnë ndryshim të vendimit.

Trupi Gjykues konstatoi se nuk ka pasur ndryshim të rrethanave në këtë çështje gjyqësore dhe rrjedhimisht vendimi lidhur me kontaktet mbetet në fuqi.

Më 1 nëntor u bë publik vendimi i Trupit Gjykues i datës 8 shtator, me të cilin një dëshmitar i Prokurorisë u lejua të jepte dëshmi nëpërmjet videokonferencës për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore.

Seanca e radhës është planifikuar për të hënën, 6 nëntor 2023, në orën 9:00 paradite.

Seanca e radhës në çështjen gjyqësore *Pjetër Shala* është planifikuar për të hënën, 20 nëntor, në orën 9:30 paradite.





Në lajme të tjera, ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim i DHSK-së u takua javën e kaluar me komunitete të ndryshme në komunën e Prishtinës, Graçanicës dhe Gjilanit për t'u dhënë informacion lidhur me mandatin dhe proceset e DHS-së dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve. Ekipi për komunikim dhe ndërgjegjësim udhëton në Kosovë pothuajse çdo muaj për të krijuar dhe mbajtur dialog me komunitete të ndryshme në Kosovë.

### **Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

